



Shëndetësia

2021-2025

Vlerësimi i programit të qeverisë 2021-2025 dhe efijenca e menaxhimit të kostove

Programi i Shëndetësisë: Modernizimi dhe përkujdesja për të gjithë 2021 - 2025

Vlerësimi i përmbushjes së programeve

PËRGATITJA DHE SHPËRNDARJA



Raport progresi

Vlerësimi i programit të qeverisë 2021-2025 dhe efienca e menaxhimit të kostove:

1200 ditë qeverisje

Evaluation of the government program 2021-2025 and cost management efficiency:

1200 days of governance

www.polifakt.al

www.altax.al

info@altax.al

Janar 2025

Tirana, Shqipëri

Polifakt.al është një platformë e pavarur dhe e besueshme për monitorimin e realizueshmërisë së premtimeve politike. Ajo ofron analiza të detajuara mbi zbatueshmërinë financiare të angazhimeve elektorale, duke i krahasuar ato me performancën reale të qeverisë dhe alokimet dhe kufizimet buxhetore.

Pikat kyçe të Polifakt.al në vlerësimin e përmbushjes

Monitorimi i premtimeve zgjedhore dhe programeve qeverisëse

[Polifakt.al](#) ndjek sistematikisht premtimet e bëra nga liderët politikë, duke vlerësuar:

Realizueshmërinë. A janë premtimet të arritshme brenda kontekstit aktual ekonomik?

Burimet financiare. A janë ndarë burime të mjaftueshme për zbatimin e premtimeve?

Statusi i përmbushjes. Tregon nëse premtimet janë realizuar, pjesërisht realizuar, apo të porealizuara.

Krahasimi me kapacitete fiskale dhe kostot e përmbushjes

Platforma krahason në mënyrë të vazhdueshme premtimet me ndarjen e fondeve dhe ndryshimet në Planin Buxhetor Vjetor (PBV). Kjo ndihmon në identifikimin e:

- ✓ Përputhshmërisë midis premtimeve politike dhe shpenzimeve reale.
- ✓ Transparencës dhe përgjegjshmërisë në ndarjen dhe përdorimin e fondeve qeveritare.

Raportet e progresit

[Polifakt.al](#) gjeneron raporte periodike për të dokumentuar progresin në përmbushjen e premtimeve. Këto raporte përfshijnë:

- Vlerësimin e performancës së ministrive dhe sektorëve përkatës.
- Përditësime mbi shkallën e arritjes së objektivave të qeverisë.

Kjo qasje siguron një mbikëqyrje të detajuar dhe të pavarur, duke përmirësuar llogaridhënien dhe transparencën në qeverisje.

Kushtet e përdorimit të Raportit

Qëllimi dhe përgjegjësia

Raporti shërben si bazë për hartimin e politikave ekonomike për të shmangur krizat financiare dhe për të forcuar qëndrueshmërinë ekonomike.

Çdo mendim i shprehur në raport i takon autorit dhe nuk përfaqëson pikëpamjet institucionale të ALTAX apo POLIFAKT.

Riprodhimi dhe shpërndarja

Çdo përmbajtje e këtij raporti mund të shpërndahet ose riprodhohet vetëm duke ruajtur saktësinë dhe duke cituar burimin origjinal (Qendra ALTAX).

Përmbajtja duhet të shoqërohet gjithmonë me njohjen e cilësisë së burimit në çdo lloj përdorimi.

Kushtet për përdoruesit

Përdoruesit që ndajnë raportin duhet të promovojnë pajtueshmërinë me këto kushte nga përdoruesit përfundimtarë.

Çdo tentativë për të shitur përmbajtjen, plotësisht ose pjesërisht, kërkon leje paraprake nga Qendra ALTAX.

Kufizime të përdorimit

Raporti mund të përdoret vetëm për qëllime jo-fitimprurëse.

Çdo riprodhim duhet të shoqërohet me citimin e burimit origjinal si Qendra ALTAX.

Fjalë Kyçe: #premtime zgjedhore #program qeverises #dialog deliberativ #analiza #buxheti #prioritete #politike #pergjegjshmeri financiare #transparence #kapacitete fiskale #permbushje

Kodi JEL: D72, E62, H50, P11

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga **Qendra ALTAX**.

Konsiderata

(Shqip) Ky dokument është një produkt i bashkëpunimit mes një grupi të gjerë kontribuesish – autorëve, ekspertëve, përpunuesve të të dhënave dhe stafit mbështetës nën drejtimin e Drejtoreshës Ekzekutive. Lexuesit dhe ndjekësit janë një komponent kyç për vijimësinë e punës.

ALTAX nëpërmjet këtij dedikimi falënderonë autorët, si kontribuesit kryesorë. Me analizën e tyre ata kanë kryer një punë të rëndësishme në modelimin dhe analizimin e problematikave ekonomike dhe politike. Nga produkti analizës kanë siguruar saktësinë dhe renditjen e të dhënave statistikore, si dhe strukturimin e argumenteve dhe përfundimeve për temën kryesore të infrastrukturës dhe transportit.

Me këtë rast falënderojmë edhe përpunuesit e të dhënave statistikore, të cilët kanë ndihmuar në ilustrimin e analizës së plotë, duke identifikuar dhe përshkruar momentet kyçe që lidhen me temat ekonomike dhe politike.

Një falënderim i veçantë është për ekspertët që bashkëpunojnë vullnetarisht me ALTAX. Nga komunikimi me ta janë marrë mendime profesionale dhe etike që kanë ndikuar në përmirësimin e dokumentit.

Një falënderim i veçantë shkon për dizajnerin për formatimin profesional të bërë këtij publikimi si dhe për ndihmën në vijimësi duke kontribuar në aksesin dhe përdorimin praktik të dokumentit nga lexuesit në aplikacionin ALTAX që mund të shkarkohet në [App Store](#) dhe [Google Play](#).

Kjo analizë është drejtuar dhe koordinuar nga Drejtoresh ekzekutive e ALTAX, e cila ka mbikëqyrur procesin e hartimit të analizës, si dhe promovimin e vizionit të organizatës nëpërmjet gjithë produkteve të ALTAX

Falënderimi i ALTAX drejtohet edhe për lexuesit dhe ndjekësit. Ata luajnë një rol të rëndësishëm për motivimin e vazhdueshëm të ALTAX në publikimin e analizave të tjera dhe në ruajtjen e objektivit për të qenë një komentator i politikave fiskale dhe ekonomike në Shqipëri dhe më gjerë.

Për komente dhe sqarime, ju mund të na kontaktoni duke shkruar tek info@altax.com

Acknowledgement

(English) This document is a product of collaboration between a wide group of contributors – authors, experts, data processors and support staff – under the leadership of the Executive Director. Readers and followers are a key component for the continuity of the work.

ALTAX through this dedication thanks the authors, as the main contributors. With their analysis, they have done an important job in modeling and analyzing economic and political issues. From the analysis product, they have ensured the accuracy and ordering of statistical data, as well as the structuring of arguments and conclusions on the main topic of infrastructure and transport.

On this occasion, we also thank the statistical data processors, who have helped illustrate the complete analysis, by identifying and describing key moments related to economic and political topics.

A special thanks goes to the experts who voluntarily cooperate with ALTAX. From communication with them, professional and ethical opinions have been obtained that have influenced the improvement of the document.

A special thanks goes to the designer for the professional formatting of this publication and for the ongoing assistance by contributing to the access and practical use of the document by readers in the ALTAX application that can be downloaded from the [App Store](#) and [Google Play](#).

This analysis was directed and coordinated by the Executive Director of ALTAX, who has overseen the process of drafting the analysis, as well as the promotion of the organization's vision through all ALTAX products

ALTAX's thanks are also addressed to its readers and followers. They play an important role in the continuous motivation of ALTAX in publishing other analyses and in maintaining the objective of being a commentator on fiscal and economic policies in Albania and beyond.

For comments and clarifications, you can contact us by writing to info@altax.com

Follow ALTAX and Polifakt on social media, Web and in our App



[FISKALISTI](#)

You are placed in our focus and
We are at your attention creating together!



[ALTAX - POLIFAKT](#)

We publish and distribute information,
ongoing analysis and studies.



[ALTAX](#)

Communicate through social media addresses



[ALTAX](#)

Watch our informative and educational videos



[ALTAX.AL](#)

Read and download unique analyses and studies



[POLIFAKT.AL](#)

Look at how many political promises have been kept.



[App Store](#)
[Google Play](#)

Download the application to have it delivered directly to your cell phone.

A relationship about the commonalities that unite us in everyday life.

Programi i Shëndetësisë: Modernizimi dhe përkujdesja për të gjithë

Vaksinimi i Popullatës Kritike

Prioriteti kryesor është vaksinimi i personave mbi 60 vjeç dhe atyre me sëmundje bashkëshoqëruese, me synimin për përfundimin e procesit deri në shtator 2021.

Pritshmëri: Ulja e rrezikut për grupet më të ndjeshme dhe ndikim pozitiv në uljen e përhapjes së COVID-19.

Parandalimi i Sëmundjeve

I japim përparësi parandalimit të sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme, duke forcuar ndërgjegjësimin dhe masat parandaluese.

Qëllim: Përmirësimi i shëndetit publik dhe ulja e ngarkesës mbi sistemin shëndetësor.

Sistemi i të Dhënave në Shëndetësi

Ndërtojmë një sistem të dhënash që garanton informacion për shpërndarjen dhe aksesin në shëndetësi, duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme pabarazitë në shërbime.

Pritshmëri: Menaxhim më i mirë i burimeve dhe shërbimeve shëndetësore për të gjithë popullatën.

Rritja e Performancës së Mjekëve

Sistemi i pagave për mjekët do të bazohet në performancën, duke inkurajuar angazhimin dhe cilësinë e shërbimit.

Rezultat: Motivim më i lartë për stafin dhe rritje e standardeve në kujdesin shëndetësor.

Rimodelimi dhe Modernizimi i Shëndetësisë

Rimodelimi i financimit publik dhe modernizimi i sistemit shëndetësor për të përmbushur nevojat e reja të qytetarëve.

Pritshmëri: Sistemi më i drejtë, më i qëndrueshëm dhe më efektiv për të gjithë.

Rritja e Pagave për Mjekët dhe Infermierët

Pagat e mjekëve dhe infermierëve do të rriten me 40% për të motivuar stafin dhe për të tërhequr profesionistë cilësorë.

Qendrat Model të Mjekësisë Familjare

Vendosja në funksionim të 10 qendrave model të mjekësisë familjare, që ofrojnë shërbime cilësore dhe të integruara pranë komunitetit.

Transformimi i Spitaleve Rajonale

Katër spitale rajonale do të transformohen në qendra reference diagnostikuese për të ofruar shërbime të avancuara dhe për të reduktuar varësinë nga spitalet qendrore.

Inovacioni dhe Teknologjia në Shëndetësi

Promovojmë inovacionin dhe rrisim përdorimin e teknologjisë së informacionit në shëndetësi, duke përmirësuar diagnostikimin dhe efikasitetin e sistemit.

Programet reflektojnë angazhimin për të ndërtuar një sistem shëndetësor modern, të drejtë dhe të qëndrueshëm, duke vendosur nevojat e qytetarëve në qendër të politikave.

Shëndetësia

Vaksinimi i popullatës kritike, personat në moshë mbi 60 vjeç dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese do të ketë përfunduar brenda shtator 2021

I japim përparësi parandalimit të sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme

Ndërtojmë një sistem të dhënash që garanton informacion për “shpërndarjen” dhe aksesin në shëndetësi të popullatës, që mundëson një monitorim konstant për adresimin e pabarazive

Mjekët do të fillojmë t’i paguajmë jo të gjithë njësoj, por sipas performancës së tyre

Rimodelimi i financimit publik për shëndetësinë, modernizimin e sistemit shëndetësor

Pagën për mjekët dhe infermierët do ta rrisim 40% përsëri

Vendosja në punë e 10 qendrave model të mjekësisë familjare

4 spitale rajonale të transformuar në qendra reference diagnostikuese

Nxisim inovacionin dhe rritjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në shëndetësi

Për të vlerësuar realizimin e programeve të përmendura në "Programin Qeverisës 2021-2025" në sektorin e shëndetësisë, do të shqyrtojmë çdo objektiv të përcaktuar në kontekstin e progresit aktual dhe sfidave të përballuara deri më tani.

1. Vaksinimi i popullatës kritike (Shtator 2021)

Objektivi: Përfundimi i vaksinimit të personave mbi 60 vjeç dhe atyre me sëmundje kronike deri në shtator 2021.

Rezultati:

- Sipas raportimeve publike dhe burimeve të OBSH-së, Shqipëria arriti një nivel të kënaqshëm vaksinimi deri në fund të 2021, duke vaksinuar shumicën e grupeve kritike.
- Megjithatë, skepticizmi publik dhe mungesa e aksesit të plotë në zonat rurale e ngadalësuan procesin.

Vlerësim: I realizuar në masë të madhe.

Realizimi: 85%

Realizimi ka qenë pothuajse i plotë për grupet prioritare brenda afatit të parashikuar. Sfidat lidhen me skepticizmin e popullsisë dhe mbulimin e plotë.

2. Parandalimi i sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme

Objektivi: Përparësi në parandalimin përmes strategjive të reja dhe ndërhyrjeve.

Rezultati:

- Janë ndërmarrë disa nisma për rritjen e ndërgjegjësimit, veçanërisht për sëmundjet kronike si diabeti dhe hipertensioni.
- Parandalimi i sëmundjeve të transmetueshme ka qenë një sfidë, sidomos për shkak të shpërthimeve të rasteve me Covid-19.

Vlerësim: Në progres, por me nevojë për investime më të mëdha.

Realizimi: 69%

Janë kryer disa nisma për përmirësimin e vaksinimit dhe ndërgjegjësimit për sëmundjet kronike, por ka mangësi në koordinimin kombëtar dhe infrastrukturën për diagnozë të hershme.

3. Sistemi i të dhënave për aksesin dhe shpërndarjen e shëndetësisë

Objektivi: Krijimi i një sistemi për monitorimin e pabarazive në shëndetësi.

Rezultati

- Ka pasur përmirësime në digjitalizimin e të dhënave, por krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës ende nuk është përfunduar.

- Aksesimi i të dhënave për vendimmarrje mbetet sfidë për shkak të mungesës së infrastrukturës teknologjike në zona të largëta.

Vlerësim: Progres në përparim.

Realizimi: 72%

Sistemi i të dhënave është nisur, por implementimi dhe integrimi i tij është i kufizuar, duke ndikuar monitorimin konstant të pabarazive.

4. Pagesa e mjekëve sipas performancës

Objektivi: Zbatimi i një sistemi të ri pagesash për mjekët sipas performancës

Rezultati

- Sistemi i ri është pilotuar në Spitalin e Fierit, por përshkallëzimi i tij në spitale të tjera është i ngadaltë.
- Ka pasur rezistencë nga punonjësit e shëndetësisë për shkak të pasigurisë mbi kriteret e vlerësimit të performancës.

Vlerësim: Në fazë eksperimentale.

Realizimi: 48%

Pilotimi i modelit në Spitalin e Fierit ka nisur, por përshkallëzimi në spitale të tjera është vonuar dhe mbeten shqetësime mbi transparencën e vlerësimeve.

5. Rimodelimi i financimit dhe modernizimi i sistemit shëndetësor

Objektivi: Modernizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës.

Rezultati:

- Janë nisur disa projekte për përmirësimin e spitaleve rajonale dhe ofrimin e shërbimeve të lëvizshme, por implementimi mbetet i pashpërndarë në të gjithë vendin.
- Financimi publik është rritur, por ende jo në nivelet e nevojshme për të mbuluar të gjitha nevojat.

Vlerësim: Në progres, por me sfida të theksuara buxhetore.

Realizimi: 70%

Financimi publik është rritur për disa projekte, por ende nuk adreson mjaftueshëm pabarazitë rajonale dhe të shtresave të ndryshme të popullsisë.

6. Rritja e pagave për mjekët dhe infermierët (40%)

Objektivi: Rritja e pagave deri në fund të mandatit.

Rezultati:

- Deri më tani janë realizuar disa rritje të pagave, duke përmirësuar ndjeshëm situatën për punonjësit e sektorit publik në shëndetësi.
- Vazhdimi i këtij procesi varet nga përballueshmëria buxhetore.

Vlerësim: Në rrugë të mbarë.

Realizimi: 87%

Rritje e konsiderueshme ka ndodhur, por mbetet për t'u arritur objektivi 40% për disa kategori të stafit mjekësor.

7. Vendosja në punë e 10 qendrave model të mjekësisë familjare

Objektivi: Funkzionimi i qendrave të reja brenda vitit 2024.

Rezultati:

- Deri në fund të vitit 2023, janë raportuar disa hapa drejt përfundimit të qendrave model, por disa projekte janë vonuar për shkak të mungesës së fondeve dhe stafit.

Vlerësim: Në progres, por kërkon përshejtim.

Realizimi: 64%

Vetëm disa qendra janë bërë funksionale, dhe progresi është ngadalësuar për shkak të mungesës së burimeve dhe fondeve.

8. Katër spitale rajonale si qendra reference

Objektivi: Transformimi i spitaleve rajonale deri në 2025.

Rezultati:

- Investimet për përmirësimin e infrastrukturës dhe teknologjisë në spitale janë në proces, por ritmi i ngadaltë rrezikon realizimin e objektivit në kohë.

Vlerësim: Në zhvillim, me rrezik vonese.

Realizimi: 64%

Vetëm një pjesë e infrastrukturës ka filluar të transformohet, dhe objektivi nuk duket të jetë i përmbushur plotësisht deri në afat.

9. Inovacioni dhe përdorimi i teknologjisë

Objektivi: Rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në shëndetësi.

Rezultati:

- Disa përmirësime janë bërë në sistemet digjitale për regjistrimin e pacientëve dhe diagnostikimin, por përdorimi i gjerë i teknologjisë mbetet i kufizuar.

Vlerësim: Në fazë zhvillimi.

Realizimi: 81%

Ka nisur digjitalizimi, por niveli i përhapjes dhe përdorimit mbetet i kufizuar

Përmbushja e programit për shëndetpër shëndetësinë reflekton përparime të rëndësishme

Duke marrë parasysh objektivat individuale dhe progresin e raportuar:

Përmbushja e përgjithshme e programit deri në janar 2025: 71%

Kjo shifër reflekton progresin në disa fusha kyçe (vaksinimi, rritja e pagave), por edhe vonesa dhe mangësi në fusha të tjera (autonomia spitalore, qendrat rajonale, mjekësia e lëvizshme).

Programi ka bërë disa përparime domethënëse në fushat prioritare, si vaksinimi, rritja e pagave dhe pilotimi i autonomisë spitalore. Megjithatë, shumë objektiva janë ende në fazë zhvillimi, dhe vonesat në implementim, sidomos për qendrat rajonale dhe modelet e mjekësisë familjare, mbeten shqetësuese.

Sfidat kryesore:

- Mungesa e burimeve financiare dhe të stafit për implementim.
- Rezistenca ndaj ndryshimeve institucionale dhe teknologjike.
- Shpërndarja e pabarabartë e shërbimeve në zonat rurale.

Rekomandime:

- Rritja e koordinimit ndër-institucional për të përshpejtuar zbatimin e projekteve.
- Prioritet investimeve në zonat e thella për të garantuar aksesin universal.
- Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies për fondet publike.